



Republika Kosova-Republika e Kosovës-Republic of Kosovo



Opština štrpce

Komuna e Shtërpçës

Municipality of Strpce

REPUBLICA KOSOVO-REPUBLIKA E KOSOVËS
OPŠTINA ŠTRPCE-KOMUNA E SHËTËRÇËS

01/Br.Prot. IZLAZNI - DALËSE
Nr.Prot. 01 - 020/08-2516/18
Br.str. 24
Nr.i fq. 24
Datum 28.02.2018
Data 28.02.2018
ŠTRPCE - SHËTËRÇË

Në mbështetje të nenit 12, 17, 40 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, të neneve 10 dhe 34 të Statutit të Komunës së Shtërpçës 01-Nr 898 të datës 14/07/2010, Kuvendi i Komunës së Shtërpçës në mbledhjen e mbajtur më datën 26.02.2018 miratoi këtë :

V E N D I M

PËR MIRATIMIN E RAPORTIT TË PUNES SE QEVERISË KOMUNALE PËR VITIN 2017.

I

Miratohet raporti i pyes se Qeveris Komunale për vitin 2017 sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

II

Ky vendim hynë në fuqi ditën e nënshkrimit nga ana e Kryesuesit te Kuvendit Komunal .

KRYESUESI I KUVENDIT TË KOMUNËS



Predrag Grbic



Opština Štrpce – Kancelarija Predsednika

OPŠTINA ŠTRPCE KOMUNA E SHTËRPECËS
 03/Br. Prot. IZLAZNI - DALËSE
 Nr. Prot. 02-030107-1314/18
 Br. str. 24
 Nr. i fq.
 Datum 14.02.2018
 Data



Komuna e Shtërpcës – Zyra e Kryetarit ŠTRPCE Shtërpcë Municipality – Mayor's office

	Data/ Datum/ Date	Shkurt 2018
	Ref.	
Për/Za/ For:	Kuvendi Komunal Shtërpcë	
Përmes/Preko/ Through	Arkivës	
Nga/Od/ From:	Bratislav Nikolic, kryetari	
Lënda/Predmet/ Subject:	Raporti gjashtëmujori punës së Kryetarit – për vitin 2017	

Të nderuar këshilltarë,

Udhëhequr nga ideja e krijimit të një cilësie më të mirë dhe kualitative të jetës në mjedisin tonë, vëmendja jonë u fokusua në përmirësimin e jetës së të gjithë qytetarëve në komunë. Duke pasur parasysh përvojën e madhe që kemi, falë punës së përkushtuar dhe mbështetjes së partnerëve dhe bashkëpunëtorëve tanë, ne kemi arritur të pozicionojmë veten si një institucion serioz dhe i respektuar, i cili me përgjegjësi të madhe ndihmon dhe lehtëson jetën e qytetarëve, pavarësisht problemeve të shumta.

Në vitin 2017, si në vitet e mëparshme, Komuna e Shtërpcës për prioritet në punën e saj e vuri theksimin në ofrimin e shërbimit më të mirë për qytetarët e saj dhe gjetjen e mundësive për krijimin e vendeve të reja të punës.

Duke pasur parasysh përbëshmeri e periudhës së social dhe ekonomik në ter rajonin, me drejt mund të themi se viti 2017, ishte plot me stabilizim dhe zhvillim mesatare të komunës së Shtërpcës. Me përkushtim të plotë dhe angazhimin e të punësuarve në qeverinë lokale gjatë periudhës raportuese, ka filluar implementimin e infrastrukturës dhe projekteve zhvillimore të rëndësishme. Ajo ka ndikuar fuqishëm se, pavarësisht pengesave të shumta dhe sfidave, komuna e Shtërpcës merr imazhin e saj të ri - imazhin e Komunës së bashkëkohore, moderne dhe të shquar, e cila më përkushtim punon, në krijimin e kushteve për përmirësimin e kushteve të jetës së qytetarëve të saj.

Komuna e Shtërpcës në vitin e kaluar ka realizuar disa projekte për zhvillim ekonomik, të cilat janë lidhur kryesisht me organizatat ndërkombëtare, objektivi kryesor të cilave është realizimi i projekteve ekonomike. Unë do të kisha veçuar projektin i UNDP / InTerDev2 (Iniciativa për

Zhvillimin Territorial), financuar nga Agjencia Austriake për Zhvillim, objektivi kryesor i të cilëve janë krijimi i vendeve të reja punës dhe përmirësimi i standardeve e jetesës për shtresat më të rrezikuara të popullatës. Do të kisha përmendur dhe projektin i AKT-LS të financuar nga USAID-i, që lidhet me zhvillimin e infrastrukturës në Komunën tonë. Gjithashtu, dhe projekti i financuar nga qeveria zvicerane dhe të cilën e realizon HELVETAS, e cila për prioritet ka përmirësimin të aftësive sipërmarrëse dhe punësimit rural. Theksi më i madh dhe në këtë vit, kur bëhet fjala për projektet ekonomike, u vu në mbështetjen e qytetarëve të komunitetit tonë të cilët janë të angazhuar në bujqësi, dhe kultivimin i mjedrës, fermerët dhe prodhuesit e mjaltit, dhe mjeshtrit të profileve të ndryshme.

Zhvillimi i turizmit si parakushti kryesor për zhvillimin e përgjithshëm ekonomik në Komunën tonë mbetet sfida më e madhe. Në të ardhmen, komuna do të jetë plotësisht e angazhuar për të gjetur mundësi për zhvillimin e qendrës së skijimit. Ne do të përpiqemi që përmes partneritetit publiko- privat ta realizojmë, më në fund, dhe zgjidhmi këtë çështje afatgjatë. Me realizimin e këtij projektit, do të ofrojmë mundësi të mëdha për punësimin e banorëve lokale, si dhe mundësi për zhvillimin e turizmit rural dhe zhvillimin e të gjitha degëve të tjera të bujqësisë dhe mbi të gjitha të bujqësisë.

Të përcaktuar si një komunë stabile, multietnike, udhëheqja dhe administrata komunale gjithashtu kanë kushtuar pjesën e madhe të punës së tyre në promovimin, kujdesin dhe mbrojtjen e trashëgimisë kulturore të gjithë komuniteteve duke respektuar dallimet.

Për periudhën janar- dhjetor vitit 2017. Zyra e Informimit Publik ka përmirësuar ndjeshëm punën e saj, duke i informuar të gjithë qytetarët tanë për punën e autoritetit legjislativ dhe ekzekutiv e komunës. Në këtë mënyrë, qytetarët ishin në gjendje të monitorojnë në detaje punën e Kuvendit Komunal dhe të Administratës komunale, për t'u informuar për të gjitha projektet dhe ngjarjet e rëndësishme e komunës.

Sa i përket infrastrukturës në vitin 2017, një theks i veçantë vihet në zhvillimin, mirëmbajtjen dhe modernizimin e infrastrukturës, dmth. rrjetet e ujësjellësit, rrjetet e kanalizimit, rrugët, ndriçimin rrugor, objekteve sportive dhe të gjithave që i bën vendbanimet tona në komunë një vend më të mirë për të jetuar sot. Këtu do të doja të theksoja se procesi i përcaktimit të prioritetëve të projekteve të infrastrukturës ishte transparent dhe se qytetarët tanë morinë vendim të cili projekto do të zbatohet në një vendbanim të caktuar, përmes pjesëmarrjes në debatet publike. Duke pasur parasysh faktin se buxheti komunal është jashtëzakonisht i vogël, Komuna ka realizuar pjesën më të madhe të projektit në partneritet me institucionet e nivelit qendror dhe partnerët ndërkombëtarë.

Situata e sigurisë në komunën tonë në përgjithësi ishte e mirë gjatë periudhës raportuese. Gjatë periudhës së kaluar, ka vazhduar bashkëpunimin e mirë me Shërbimin Policor të Kosovës dhe stacionit KP në Shtërpce. Gjithashtu, ka punuar në mënyrë efikase e Komiteti Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSBS).

Nga aspekti politik, dua të theksoj aktivitetet që kanë kontribuar në investimet në komunën e Shtërpçës po ashtu dhe të vlerësoj se Shtërpçe është ende shembulli më i mirë i bashkëjetesës së mirë të serbëve, shqiptarëve dhe komuniteteve të tjera në Kosovë.

Në mënyrë që raporti të jetë sa më i qartë, më poshtë janë paraqitur raportet veçanta të drejtorive komunale.

Administrata e Përgjithshme

Gjatë ë periudhës raportuese Drejtoria e Administratës është angazhuar maksimalisht, për të përmbushur detyrimet dhe detyrat që dalin nga ligji. Është bërë koordinimi i punimeve dhe përmirësimi e mekanizmave ekzistues për realizimin: të drejtave ligjore të qytetarëve, mbrojtjen e të drejtave të njerëzve, barazia gjinore, krijimin e mundësive të barabarta për të gjithë qytetarët, respekt për tolerancë ndëretnike, rritje të ekspertizës dhe më shumë.

Drejtorja e Administratës në bazë të planit të punës ka kryer detyrat dhe përgjegjësitë e saj profesionale në meny qe të kontribuojë në krijimin dhe implementimin e politikave komunale në fushën e administratës lokale, përgatitje dhe mbështetje seancave e kuvendit dhe komiteteve të tij, më shërbimet e përbashkëta, shërbimit e mirëmbajtës së hapësirave në objektet e komunës. Ofrimi i shërbimeve për qytetarët nëpërmjet zyrave të Ofiqarise dhe zyrës së pritëse, përzgjedhje, mirëmbajtje dhe ruajtjes së dokumentacionit në arkivin komunal, më shumë.

Drejtorja e administratës ka kryer edhe shërbimin profesional për Kuvendin dhe Zyrën e kryetarit, si dhe ka ndihmuar edhe drejtorë tjerë për çështjet administrative. Për përgatitjen e materialeve (vendimet, rregulloret dhe tjerat) për takimet të kuvendit, pushteti ekzekutiv, përgatitja, përkatësisht nxërja e kopjave të procesverbaleve nga seancat e kuvendit dhe të komiteteve, si dhe është bërë përkthimi i të gjitha akteve të miratuara nga ana e këtyre organeve, duke u mbështetur në dispozitat e Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale.

Duke u bazuar në përgjegjësitë dhe kompetencave sipas ligjit në fuqi, Ministria e Administratës së Pushtetit Lokal (MAPL), e zbaton procesin e monitorimit në Komunitat, drejtoria ka raportuar rregullisht për çështjet kryesore nga fushë veprimtaria e Komunës

Është e rëndësishme të theksohet se komuna e Shtërpçës në „Raportin Komunal për Performancën Komunale për vitin 2016, i cili është bërë nga MAPL, ishte i shtati për efikasitetin e arritur. Përkundër këtij sukcesi, qëllimi ynë është që të punojmë edhe më shumë në periudhën e ardhshme për të përmirësuar shërbimet ndaj qytetarëve.

Zyra e Shërbimeve për Qytetarë-

Qendra e afron shërbimet qytetareve përmes zyrës e pritëse në cilën bëhet: pranimi i lendeve nga palët, përpunimi i tyre, duke dhënë ndihmën profesionale palëve të interesuara.

Gjatë kësaj periudhe, nëpërmjet zyrës së pranimi janë pranuar artikujt si në vijim:

Spektori i Shërbimit të Ofiqarisë- i cili punon në kuadër të Departamentit të Administratës së Përgjithshme, me zyrat e tij në Shtërpçë, Drajkovc, Sevce dhe Brod, të cilat janë të organizuara dhe funksionojnë në mënyrë të shumë mirë.

Spektori i Gjendjes Civile me stafin e tij në periudhën Janar-Dhjetor 2017, ishte angazhuar në ekzekutimin dhe pranimin e kërkesave, si dhe zbatimin e tyre në praktikë.

Janar-dhjetor 2017	Vërtetimi nga arkivi	Ekstrakt	Certifikatë e lindies	Certifikatë e martesës	Certifikatë e vdekies	Statut martesor	Aktivdim mbi Regj.e vonuar	Deklarata familiare	Nënshtetësia	vendbanimi	Procesverbal për pranimin e atësisë	Dëshmi për vdekje
Sasia	155	4835	765	677	418	180	51	793	55	448	63	47
Gjithsejtë	8486 Lënde											
Lëndë të kryera												

Zyra për barazi gjinore-

Në periudhën janar-dhjetor 2017 zyrtare për barazi gjinore dhe të njëjtën kohë edhe anëtare i njësisë për drejtat e njeriut, ka kushtuar vëmendjen e respektimit barazisë gjinor,

- Gjatë këtyre muajve janë realizuar takimet të rregullta më OSCE-ne, me „ Grupin jo formal të grave “ dhe me organizatën joqeveritare „Fame Space” dhe „IKEBANA”.
- Më rastin e ditës e ndërkombëtare të gruas „8mars” është mbajtur një tubim me grat. E ka financuar komuna.
- Është realizuar takimi me KFOR-in.
- Është mbajtur punëtorja për Buxhetimi me përgjegjësi gjinore

- Janë mbajtur 6 takime për Siguri në të cilën kanë marr pjesëmarrje dhe përfaqësuesit për barazi gjinore
- Janë mbajtur disa takime me OJQ „ Grat për Grat”, NDI,CPT,VIZIONITA për drejta pronësore.
- Është mbajtur punësoria për Fuqizimi i grave, nga komunitetit pakicë, për të bërë përparim në karrierë.
- Është mbajtur punësoria për: Fuqizimi i kapacitetit OJQ-ës dhe përfaqësuesve të institucioneve për përkrahje e grave të cilat përjetojnë dhunë.
- Janë ndarë certifikatat grave nga komuna e Shtërpcës, të cilat kanë ndjekur trajnimin për drejtët pronësore.
- Është mbajtur punësoria për planifikimi i biznesit, marketing dhe shitje.
- Dhënia e diplomave grave nga komuna e Shtërpcës, të cilat kanë ndjekur trajnime për Drejtët pronësore.
- Është mundësuar falas këshilla ligjore për qytetarët e komunës së Shtërpcës.
- Është mbajtur takim me ambasadorin e SH.B.A.-së Z. Greg Delavi për situatën ekonomike në komunë.
- Prezantimi i raportit nga Udhëzimi Administrativ Nr. 03/2016 për masat e veçanta për regjistrimin e pronës së paluajtshme të përbashkët në emër të to dyve bashkëshortëve.
- Janë mbajtur disa takime me përfaqësuesit e Avokatit të Popullit
- Për shkakun e 16 ditë aktive kundër dhunës ndaj grave, jan mbajtur disa trajnime për mbrojtje e grave

Zyra e Arkivit – e mban evidencën të gjithave akteve të pranuar dhe komunikon me qytetarët në meny korrekte dhe transparente në gjuhën e tyre anëtare

Zyra e kryen dhe shërbimet e arkivit ku behet ruajtja e lindave të përfunduar(lëndat pasive) dhe mirëmbajtja e librave e arshivës në sistemin digjital. Ne këtë zyre behet ruajtja e të dhënave në formë elektronike.

Përdorimi i veturave zyrtare – Drejtoria është duke bërë mbikëqyrje për mënyrën e shfrytëzimit të automjeteve të komunës, është mbajtur evidencë për numrin e kilometrave të kaluara si dhe për sasinë e shpenzimit të karburanteve në përputhje me rregulloren mbi shfrytëzimit.

Gjatë kësaj periudhe raportues e kemi këtë gjendje te shpenzimeve te derivateve:

- Dizel 10861 L
- Benzinë 9010 L
- Plin 220 L

Shërbimet Teknike- Në këtë sektor kemi punuar në të gjitha punët parashikuar e lidhur me mirëmbajtjen e ndërtesës së komunës; sigurimin i objekteve të Komunës; mirëmbajtja e higjienës në objektin; shërbime hoteliere nga bufeja e Komunës për nevojat e zyrtarëve të Komunës; mirëmbajtja teknologjisë informative organizimi dhe shfrytëzimi i veturave zyrtare dhe mundem me thonë që kemi arritur rezultate relativisht të mira.

Menaxheri i IT-ës/ Zyrtari për Informim publik për përudhen janar-dhjetor vitit 2017, ka kryer këto punë:

- Mirëmbajtja e përditshme LAN dhe ÈAN rrjetit
- Mirëmbajtja e përditshme kompjuterëve dhe pajisjeve të përcjellëse në komunën e Shtërpçës
- Mirëmbajtja e PTK-ës, internetit dhe rrjetit telefonik
- Mirëmbajtja e rrjetit qeveritar në bashkëpunim me zyrtarët e IT-së nga MAPL
- Puna në organizimin e debateve publike për buxhetin.
- Puna në organizimin e diskutimeve publike.
- Azhurnimi i përditshëm i ueb faqes komunale dhe FB profilit e komunës.

S ai përket kërkesave për qasje në dokumente publike, komunës së Shtërpçës në periudhën janar –dhjetor 2017 janë parashtruar 5 kërkesa. Parashtruesit e kërkesave përgjigje kanë marr në afatin ligjor.

Buxheti dhe Financat

Detyrat bazë të Drejtorisë në përgjithësi, si dhe të veçanërisht sektorit janë në bazë të Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe përgjegjësisë nr.03/L-048, Ligji për Financat e Pushtetit Lokal Nr.03/L-049, Rregullorja komunale për Taksat, Tarifat dhe Gjobat Komunale, nr.01-16-927 të datës 04.04.2012, si dhe Ligjit, Rregulloreve dhe Udhëzimet Administrative të tjera nga niveli qendror që trajtojnë aspekte të ndryshme të funksionimit të sektorëve të lartpërmendur.

Duke bazuar në këto dokumente si dhe në planin aksionar të paraqitur që në fillim të vitit, drejtorja për Buxhet dhe Financa gjatë periudhës janar – dhjetor 2017 e ka kryer këto zhvillime:

Gjatë vitit 2016 në drejtori Buxhetit dhe financave janë kryer këto aktivitete

Raportet financiare

Gjatë vitit 2017 drejtorja për buxhet dhe financa ka punuar raportet vjetore financiar për vitin 2016. Duke bazë të rregullat financiare 07/2011 është bërë raporti ekstrem financiar i cili

dërgohet në Ministrinë e Financave, deri më 30 janar, në çdo vit, ku në bazë e këtij raportit bëhu edhe raporti vjetor i auditivi prej Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm në Prishtinë. Prveq këtij raportit e përmendur është bërë edhe raporti i brendshëm vjetor për vitin 2016, i cili dërgohet Kuvendit komunal për shqyrtim. Gjatë çdo vitit janë 4 raportet të brendshëm financiar, të cilat punohen në çdo tre muaj.

Auditivi gjatë vitit 2017

Gjatë vitit 2017, kemi pasur 3 auditime dhe ato:

- Zyra e Tatimit në pronë, Ministrisë e Financave, të lidhje me punë e zyrës komunale tatimit në pronë për vitin 2016.
- Zyra e Auditivit të Përgjithshëm, të lidhje me raportin vjetor financiar të Komunës së Shtërpçës për periudhën 2016 si edhe
- Zyra e Auditivit të Përgjithshëm KK Shtërpçe të lidhur me menaxhimin e pronave në komunën e Shtërpçës
- Zyra e Auditivit të Kryesor të lidhur me raportin financiar e komunës së Shtërpçës për periudhën prej 9 muaj të vitit 2017

Gjatë vitit 2015, është aprovuar Ligji për Amnistinë e borxhit për të gjithë qytetarët e Kosovës, pa dalim a janë ata persona fizikë ose juridik, që kanë borxhe ndaj institucioneve shtetërore dhe ndërmarrjet publike për periudhën deri në 31.12.2008, të ofruara për qytetarët nën të njëjtin shlyerjen e detyrimeve për periudhën 01.01.2009 - 31.12.2014 godine. Një ligj i miratuar dhe në fuqi deri 02.09.2017 vit, ka qenë një nga pikat më të rëndësishme nga analiza e kompetencave e Ministrisë e Financave, lidhur me auditimin që kemi pasur në drejtori e tatimit në pronë. Përveq kësaj, është bërë edhe kontrolli i ndërtesave të regjistruara në vitin 2016, si dhe një analizë e kontrollit të kryer të objektet e ekzistuar, të regjistruara në bazën e të dhënave. Raporti final që është bërë në bazë të auditimit të cilin kemi pasur, ende nuk është dorëzuar, megjithatë, bazuar në diskutimet që kemi pasur me personat kompetent nga Ministria e Financave, dhe në këtë viti ka përparime në punën e drejtorive komunale, në të gjitha aspektet e punës së tyre.

Përveq auditiveve të cekur, gjatë gjysmës së parë të vitit 2017, kemi pasur një auditim nga auditorët e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm e Prishtinës, lidhur me raportin vjetor të punës së komunës për vitin 2016. Në muajin qershor ka përfunduar dhe dorëzuar raporti në të cilin janë dhënë 15 rekomandime. Një pjesë e mirë e këtyre rekomandimeve janë zgjidhur në vitin 2017, gjithashtu në muaj Shtator është punuar në raportin financiar nëntëmujor për vitin 2017.

Buxheti i komunës së Shtërpçës për vitin 2017

Në bazë të ligjit nr. 05/L-125 komuna e Shtërpçës ka buxhetin fillestar prej 3.577.609 €, të hyrat vetanake të planifikuara që kapin shumën prej 446,914 € dhe grandit qeveritar në vlerë prej 3,130,695 € në bazë të së cilës është bërë plani i rrjedhjes së parasë së gatshme (kesh plani). Gjatë tremujorit e parë të vitit 2017, kemi pasur rritje e buxhetit për 109.886.97 €, si rezultati për bartjen e të hyrave vetanake të pa shpenzuara nga viti 2016. Përveq vite cekurës në fund të vitit, dmth. në tremujorin e fundit kemi ngritje në kategori Pagat edhe Mëditje në vlerë total prej +

38,467,82€ nga niveli qendrorë. Duke marrë parasysh gjithat ndryshime të cekura, buxheti total komunës së Shtërpeës për vitin 2017 është 3,725,963.79€

Korniza afatmesme buxhetore për periudhën 2018-2020

Në fund të muajit maj të këtij viti ministria e financave ka dërguar qarkoren buxhetore nr. 2018/01. Në bazë të saj është bërë KAB për periudhën 2018-2020. Të cili është aprovuar në seancën e kuvendit komunal më datën 27.06.2017. si dhe në të vitet të kaluara, ashtu edhe në këtë vit me marrjen e qarkores buxhetore nr. 2018/0, drejtoria ka punuar analizën e shpenzimeve në të gjitha 5 kategoritë e shpenzimeve për të gjitha programet buxhetore të cilat ekzistojnë në komunë. Gjithashtu në bazë të njëjtës është dërguar qarkore të brendshme të gjithë drejtoreve për propozime dhe ideja të reja të cilët mundën të implementohen në përdhën të ardhshmen, gjatë muajit qershor kemi mbajtur një debat publik, e lidhur me planifikimin e buxhetit dhe rendësi të pjesëmarrjes së qytetareve në atë proces.

Plan buxhetor për vitin 2018, si dhe parashikime për 2018 dhe 2020

Të lidhur me aktivitet buxhetor për përdhën 2018-2020 e parashikuar me planin aksionar janë mbajtur debatet publike dhe evidentimi i prioritetëve të qytetareve të komunës. Lidhur me këtë autoriteti ekzekutiv ka organizuar 6 debate publike nëpër fshatrat e komunës. Pas grumbullimit e prioritetëve organi i ekzekutiv e komunës më datën 29.08.2017, ka dorëzuar draft buxhetin për përdhën 2018-2020, kuvendit komunal për shqyrtimin dhe aprovim. Kuvendi komunal gjatë muajit shtator ka organizuar debatin publik për shqyrtimin prioritetëve buxhetor për 2018-2020 dhe në takimin e KPF 15.09.2017. Kuvendi komunal më 18.09.2017 ka shqyrtuar dhe aprovuar buxhetin e komunës për periudhën 2018-2020. Pas aprovimit e buxhetit, drejtoria për buxhet dhe financa ka kompletuar dokumentacionin më datën 28.09.2017 dhe ka dërguar Ministrisë për Financa në bazë të ligjit

Raportet mujore dhe ndryshimet

Gjatë secilit muaj drejtoria për buxhet dhe financa ka obligim të dorëzimit të listës së obligimeve komunale, pagesës së tatimit në qira dhe raportimi në administratën tatimore, ndryshimet në listat e pagave, PIP raportimi, alokimi i të hyrave vetanake, etj. Për të gjitha punët e cekur më lart janë në obligimet ligjore që të realizohen gjatë qdo muajit (përveq raportit PIP- qdo tre muaj) ku drejtoria si dhe në vitet e kaluar nuk ka pasur asnjë leshim në ato, dhe ka në tëresi e ka realizuar të gjitha që janë të caktuara me ligj

Të hyrat vetanake

Të hyrat e planifikuara vetanake në vitin 2017 kapin shumën prej 446.914 €. Por inkasimi për vitin 2017 e kap vlerën prej 247,449.85 ose 77.16% nga e planifikuara. Nëse krahasojmë me vitin kaluar për të njëjtën periudhën e kanë kapur shumën prej 260,401. €(-12,952.07€).

burimet të hyrave të cilët ka ardhur deri të zvogëlimi në pagesat, janë të hyrat nga tatimi, të tjerat të hyrat kanë mbetur të njëjta. Shihen pagesat më të larta gjatë vitit 2016. Shkaku i pagesave më të larta, është aprovimi i ligjit nga Qeveria, lidhur me faljen e borxhit tatimit në pronë. Ligji i cekur ka afuar qytetareve mundësin më të mirë për pagesë, ku është përfshirë dhe falja e borxhit për përdhën prej 2002-2008

Planifikimi, Rindërtimi, Urbanizmi dhe Mbrojtja e Mjedisit

Aktivitetet e realizuara nga drejtoria për planifikim, rindërtim, urbanizëm dhe mbrojtje të mjedisit jetësor gjatë vitit 2016 të janë: procesi i legalizimit i objekteve, puna me palë, pranimi dhe shqyrtimi i kërkesave, kontrolli i ndërtimit, dërgimi i kërkesave në ministri të ndryshme për realizimin e projekteve, punë në hartimin e planeve aksionar për efikasitetin energjetik, etj.

Pas caktimit e lokacionit për ndërtimin e pesë objekteve për vendosje e personave e zhvendosur të cilit tani banojnë në qendrat kolektive, drejtoria ka qenë angazhuar për lëshimin e lejeve të nevojshme për realizimin e këtij projektit. Ka filluar ndërtimi i njësisve të banimit. Projekti u financuar nga EU dhe Ministria për Komunitete dhe Kthim, dhe implementohet nga KDR- Këshilli Danez për Refugjat.

Përveç këtyre 5 ndërtesa më njësi e banimit, do të ndërtohen dhe 4 shtëpi individuale, prej të cilave tani më janë ndërtuar dy, deri sa ndërtimi i tjerave planifikohet në vitin 2018

Nga USAID, në bashkëfinancim me komunën, është realizuar projekti I zëvendësimi I kaldajave ekzistuese për ngrohje qendrore: për ndërtesën e komunës dhe qendrën e kulturës në Shtërpce, në shkollën e mesme” Jovan Cvijic’ në Shtërpce dhe shkollën fillore “ RazimCokli” në f. Brod.

Dy projekte janë financuar nga CDF në bashkëfinancim me komunën. Renovimi I fushës sportive në Vrbeshticë dhe ndërtimi I qëndresë së kulturës në Biti e E.

Nga Ministria e Administratës së Pushtetit Lokal është financuar projekti I rikonstruimi I ndriçimit publik e ekzistuar në Komunën e Shtërpces, faza e par .

Punonjësit e drejtorisë kanë pasur pjesëmarrjen e aktive në komisionet e vlerësimit e ofertave, ndarjes së tenderëve, si dhe monitorimi i projekteve.

Disa here gjatë vitit kemi pasur vizita punës së inspektoreve nga Ministria së Planifikimit Hapësinor, Ata së basku me inspektoret e ndërtimit kanë kontrolluar ndërtimin në territorin e Parkut Ndërkombëtar

Inspektorat e ndërtimit gjatë kësaj periudhe kanë shqiptuar: 2(dy)gjoba mandatarë, janë bërë 45 procesverbale, lidhur me mosrespektimin e Ligjit për ndërtim, është marr 1(një) vendim për ndalim të punimeve, si dhe një vendim për prishje e objektit të paligjshëm.

Aktivitet tjetër të cilat I kanë kryer punëtor e drejtorisë, janë: pranimi, përpunimi, procedimi dhe përgjigje në kërkesat e palëve, të lidhur me ndërtimin , rindërtimin si dhe çështjet që kanë të bëjnë më infrastrukturë në territorin e komunës sonë.

Shërbimi kadrovik

Shërbimi kadrovik në periudhën janar-dhjetor vitit 2017me qëllim të udhëheqjes më të mirë me resurset njerëzore dhe funksionimit më të mirë të komunës ka pasur aktivitete të shumta. Me

rregulloren mbi sistematizimin e brendshëm të administratës komunale të punësuar janë 108 punëtorë, prej tyre 71 janë serb dhe 37 shqiptarë. Në administratën komunale punojnë gjithsejtë 24 femra dhe 81 meshkuj. Është bërë analiza e nevojave të kuadrove, është punuar plani i pranimit në shërbimin civil dhe plotësimin e vendeve të punës mbi aktin e sistematizimit, varësisht nga nevoja e punës dhe mjeteve financiare në dispozicion të parapara me buxhet për këto qëllime.

Pranë mbikëqyrjes së përditshme dhe kontrollit të punës të gjithave drejtorive komunale, evidentimit të rregullt të gjitha mungesave dhe pushimeve, lëshimit të aktvendimeve dhe marrjes së akteve tjera juridike, si dhe azhurnimit dhe ruajtjes së dosjeve personale të shërbyesve civil, respektimit të orarit të punës, zbatimit të procedurave për pranim në shërbimin civil, procedurave disiplinore, ka pasur edhe aktivitete tjera.

Shërbimi kadrovik në bashkëpunim me drejtorët e drejtorive ka bërë procesin e klasifikimit në përputhje me rregulloren mbi klasifikimin dhe katalogun e vendeve të punës të parapara për shërbimin civil, propozim i klasifikimit të komunës së Shtërpcës është aprovuar nga ana e komisionit të Qeverisë së Kosovës. Sipas njoftimit të ministrisë së administratës publike ndryshimet lidhur me koeficientet dhe pagat në lidhje me sistematizimin i ri nuk janë zbatuar deri të periudha e caktuar dhe ndryshimet priten të bëhen në periudhën të ardhshme.

Pranë kontrollit të përditshëm dhe mbikëqyrjes së punës së drejtorive komunale, mbajtjes së evidencës sipas të gjitha llojeve të lëndëve, dosjeve personale të punësuarve, respektimit të orarit të punës, lëndëve sipas ankesave në aktvendime nga fusha e marrëdhënieve të barabarta, zbatimit të procedurave pranimit në shërbimin civil, procedurat disiplinore, shërbimi kadrovik në këtë periudhë sipas rekomandimit të Auditimit Gjeneral ka punuar formën elektronike të dosjes së punësuarve me qëllim të përpunimit më të lehtë dhe analizës së dokumentacionit të tërësishëm të punësuarve.

Është duke u punuar në hartimin e planit i trajnimit dhe planin e punës së trajnimit i cili do të përcaktohet me dinamikën e ndryshimit të rregullave e me këtë edhe me nevojën për avancim profesional të shërbyesve civil e të gjitha me qëllim të efikasitetit më të mirë në punë të komunës së Shtërpcës.

Në vitin e kaluar shërbimi kadrovik ka shpallur konkurs për pozitën e Teknik i pyllit në drejtori për Zhvillim Ekonomik

Ky shërbim do të vazhdoj me punën në rritjen e edukimit profesional të punësuarve në afrimin e shërbimeve cilësore për qytetarë duke u bazuar në ndërtimin e administratës profesionale dhe efikase, në përputhje me standardet Evropiane e me këtë duke respektuar parimet themelore të shërbimit civil.

Zyra e auditivit të brendshëm

Aktivitete të cilat e ka realizuar në vitin 2017 Zyra për auditivin të brendshëm janë përshkruar në ligjin për auditivin të brendshëm nr.03/L-128 dhe të gjitha më qëllimin e rritjes së efikasitetit të punës së subjekteve e shërbimit publik për të rritur nivelin e shërbimeve të cilët afrohen shfrytëzuesit dhe qytetareve e komunës.

Gjatë periudhës janar-dhjetor vitit 2017 në bazë të programit vjetor të punës janë bërë 6 auditime dhe ato:

- Kontrollimi prokurimit publik
- Kontrollimi i menaxhimit të pronës komunale
- Kontrollimi i akteve të emërimit
- Kontrollimi të hyrave në drejtori Gjeodezisë, Kadastrit dhe
- Pronës
- Kontrollimi i shpenzimeve të mallrave dhe shërbimeve në
- shëndetësi primare
- Sistemi i kontrollit për menaxhimin e lejeve të ndërtimit

Në bazë të auditivit të brendshëm numri i rekomandimeve, të dhëna në raportin janë 31 dhe ato janë :

- Rekomandime të zbatuara10
- Rekomandime të zbatuar pjesërisht.....2
- Rekomandime pa zbatuara.....19

Rekomandime pa zbatuara të cilët janë dhen në raportin, dhe nuk janë zbatuar ,do të zbatohen gjatë vitit 2018. Arsye e pamudesis së zbatimit është proceset e punës të cilët janë lëvizur për zbatim e rekomandimeve kërkon më shumë kohë për eliminimin e mungesave.

Prokurimi publik

Në bazë të ligjit mbi prokurimin nr.04/L-042, zyra e prokurimit ka udhëheqë të gjitha procedurat e prokurimit në pajtim me ligjin e prokurimit duke filluar nga hapja e ofertave deri të dhënia e kontratës.

Për periudhën e raportimit gjatë vitit 2017. Zyra e prokurimit ka iniciuar 30 procedura të prokurimit në total dhe atë:

- 9 procedura të prokurimit me vlerë të mesme, prej tyre 5 për punë, 2 për shërbime, 2 për furnizim.
- Për caktimin i çmimeve ka pasur 10 procedura dhe atë 4 për furnizim, 2 për shërbime dhe 4 për shërbime
- Janë iniciuar 11 procedura të prokurimit me vlerë minimale, vlera e të cilës nuk kalon shumë prej 1000 euro. Për furnizim 5 dhe për shërbime 6

Gjatë vitit 2017 të kaluar zyra e prokurimit ka bërë furnizimin e materialit për nevojat e drejtorive sipas kërkesave dhe ka përgatitur dhe kryer pagesat e faturave.

Në të gjitha procedurat e prokurimit kushti i tenderimit ka qenë çmimi më i ulët për dhënie e kontratës

Zyra për komunitete dhe kthim

Komuna e Shtërpçës në bazë të Rregullores Nr 2010/02 të Qeverisë së Kosovës ka formuar një zyrë komunale për komunitete dhe kthim më datën 21.04.2011, me vendimin të kryetarit të komunës nr.02. 179 dhe me rekomandimin e Komitetit për Komuniteteve të Kuvendit Komunal të Shtërpçës 01 nr. 1133 e 27.09.2010, është parashikuar që ZKK ka dy pozicione: 1. Shef i Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim dhe 2. Koordinator për kthim.

Të drejtat e komuniteteve dhe qasja në shërbimet: Kur bëhet fjalë për të drejtat e komuniteteve, të gjitha komunitetet në komunën e Shtërpçës janë trajtuar në mënyrë të barabartë të bazuara në qasjen e tyre në shërbimet e ofruara për qytetarët.

Kthimi: Sa i përket kthimit, koordinator i ZKK rregullisht kryen pranimin, regjistrimin dhe procedimin e kërkesave e të kthyerve dhe personave të zhvendosur. Në Komunën e Shtërpçës është në proces implementimi projektit i BE RRK 4, faza e fundit i BE- RRK5 faza e par. Ky projekt implementohet nga IOM (Organizata Ndërkombëtare për Migrim), Ministria për Komunitete dhe Kthim, UNHCR, ndërsa projekti është financuar kryesisht nga Zyra e Komisionit Evropian. Deri më tani përmes se këtij projekti janë asistuar gjithsejtë 7 familje.

Riatdhesimi: Gjatë periudhës së raportimit Shefi i ZKKK e komunës së Shtërpçës, ka marrë kërkesat, ka regjistruar në bazë të dhënave dhe ka përditësuar rregullisht. Sa i përket personave të riatdhesuar në vendet e treta, iu është ofruar ndihma në vijim:

